



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:221406

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05510781

Rev.nr.479/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Beshir Islami, anëtar, në çështjen juridike të paditësit Nebih Hoti nga fshati B., Komuna P., të cilin me autorizim e përfaqëson Florin Vertopi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës me seli në P., të cilën me autorizim e përfaqëson Muharrem Kurtaj nga Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti anulim vendimi, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5160/2022 të datës 10.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 26.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5160/2022 të datës 10.07.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm me aktgjykimin C.nr.823/19, të datës 20.05.2022, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit N.H., nga ..., Komuna P., ndërsa sipas ankesës së paditësit Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe në pikën

I të dispozitivit ka gjykuar si në vijim: Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Nebih Hoti nga ..., Komuna P., ashtu që anulohet vendimi numër 07/1-01A/1074 i datës 23.01.2019 dhe vendimi i Komisionit për Ankesa i Policisë së Kosovës nr.46-KA-2019, me të cilin paditësi është sistemuar prej Departamentit për Hetime, Divizioni për Hetimin e Krimeve, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion, Sektori për Hetimin e Krimeve Ekonomike, Shef i Njësisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike, në Drejtorinë Rajonale Prishtinë, Sektori i Operativës Rajonale, SP Prishtinë Veri, Sektori i Operativës, ekipi reagues "B", Udhëheqës i Ekipit Reagues. Në pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, që paditësin ta kthej në vendin e mëparshëm të punës në Departamentin për Hetime, Divizioni për Hetimin e Krimeve, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion, Sektori për Hetimin e Krimeve Ekonomike, Shef i Njësisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike. Në pikën III të dispozitivit detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës që paditësit t'i paguaj në emër të diferencës për rrezikshmëri mujore në mes të pozitës në Departamentin për Hetime, Divizioni për Hetimin e Krimeve, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion, Sektori për Hetimin e Krimeve Ekonomike, Shef i Njësisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe pozitës Drejtoria Rajonale Prishtinë, Sektori i Operativës Rajonale, SP Prishtinë Veri, Sektori i Operativës, Ekipi Reagues "B", Udhëheqës i Ekipit Reagues, t'i paguaj shumën neto për periudhën nga data 01.03.2019 deri më 31.01.2022, shumën prej 1,266.24 euro, për kontributin pensional për periudhën 01.03.2019 deri më 31.01.2022, të paguaj në Trustin Pensional të Kosovës shumën prej 70 euro, në emër të tatimit në të ardhura për periudhën nga data 01.03.2019 deri më datë 31.01.2022, të paguaj në ATK shumën prej 63.76 euro, të gjitha këto më kamatë prej 8% vjetore, duke filluar nga arritja e pagesës mujore për pagesë më datë 21.03.2019 (data e ushtrimit të padisë), deri në pagesën definitive, e të gjitha në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. Në pikën IV të dispozitivit është detyruar e paditura që duke filluar nga data 01.02.2022 e tutje, të paguaj neto diferencën mujore për rrezikshmëri në shumë prej 40 euro, si dhe diferencën e kontributit pensional-trustit për punëdhënësin 5%, në shumën prej 2 euro, deri në kthimin e vendit të punës dhe në pikën V të dispozitivit është detyruar e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguaj paditësit shumën prej 966.40 euro.

Kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë, revizion ka paraqitur i autorizuari i të paditurës për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të aprovoj si të themeltë revizionin e të paditurës, të ndryshoj aktgjyqimin e Gjykatës së Apelit, ashtu që të lë në fuqi

aktgjykimin e shkallës së parë dhe të refuzoj në tërësi si të pabazuar padinë e paditësit, duke e detyruar që ti bartë shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i paditësit ka paraqitur përgjigje në revizionin e të paditurës, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës revizionin e të paditurës ta refuzoj si të pathemeltë dhe të detyroj të paditurën në shpenzimet e përpilimit të përgjigjes në revizion në shumën prej 208 €, sipas tarifës së OAK.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, revizionin e të autorizuarit të paditurës, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se:

Revizioni i të autorizuarit të paditurës është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi ndaj të paditurës, të cilën e ka precizuar më anë të parashtrësës së datës 29.03.2022, si dhe në seancën e datës 07.04.2022, duke kërkuar që të anulohet vendimi numër 07/1-01A/1074 i datës 23.01.2019 dhe vendimi i Komisionit për Ankesa i Policisë së Kosovës nr.46-KA-2019, me të cilin paditësi është sistemuar prej Departamentit për Hetime, Divizioni për Hetimin e Krimeve, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion, Sektori për Hetimin e Krimeve Ekonomike, Shef i NJKE, në Drejtorinë Rajonale Prishtinë, Sektori i Operativës Rajonale, SP Prishtinë Veri, Sektori i Operativës, ekipi reagues "B", Udhëheqës i Ekipit Reagues dhe i njëjti të kthehet në vendin e mëparshëm të punës, kompensim e diferencës së të ardhurave personale nga data 01.03.2019 e deri në kthimin në punë, me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë mbi bazën e provave të administruara refuzoj kërkesëpadinë e paditësit, me vlerësim se transferimi i paditësit nga pozita e shefit të Njësisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike, në pozitën udhëheqës i Ekipit Reagues në Stacionin Policor Veri, është bërë në bazë të rekomandimit të Drejtorisë për Krime Ekonomike dhe Korrupsion drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, është paraqitur nevoja që disa zyrtarë përfshirë këtu edhe paditësi të transferohen në një vend tjetër të punës (për nevoja operationale), e që ky rekomandim është vlerësuar se është në harmoni me nenin 32 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, për marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës.

Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit, ka aprovuar si të themeltë ankesën, ndërsa ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë

nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale si dhe drejtë dhe plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike, por gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale. Duke vlerësuar ndryshe shkresat dhe provat të cilat janë administruar nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit nxjerr përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj është ndryshuar aktgjykimi i shkallës së parë ashtu siç është përcaktuar me nenin 201 pika b) dhe d) të LPK-së.

Kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë në trajtimin e kërkesës së paditësit nuk ka marrë për bazë dispozitat ligjore nga neni 17, paragrafi 2 të Ligjit të Punës, ku përcaktohet se: "Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuar i pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës, që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës", ndërsa sipas paragrafit 3 të këtij neni përcaktohet se: "I punësuar sipas nevojës mund të sistemohet në punë nga një vend në një vend tjetër, tek i njëjti punëdhënës në pajtim me Kontratën e Punës, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën Kolektive". Është vlerësuar se në kundërshtim me këto dispozita është marrë vendimi nga e paditura për sistemim të paditësit në pozitën Shef i NJKE, në Drejtorinë Rajonale Prishtinë, Sektori i Operativës Rajonale, SP Prishtinë Veri, Sektori i Operativës, ekipi reagues "B", Udhëheqës i Ekipit Reagues. Po ashtu, është vlerësuar se vendimet e të paditurës janë në kundërshtim edhe me Udhëzimin Administrativ nr.02/2018, përkatësisht me nenin 32 të këtij udhëzimi, ku përcaktohet është paraparë sistemimi për kohë të caktuar dhe të pacaktuar pa pëlqim të punonjësit për shkak të nevojave operacionale të shërbimit, si dhe në rast të gjendjes së jashtëzakonshme. Kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka sqaruar në masë të mjaftueshme rrethanat se me cilin akt të brendshëm të paditurës është përcaktuar dhe rregulluar çështja e nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës apo nevojat operacionale të shërbimit si dhe të gjendjes së jashtëzakonshme, në atë mënyrë që paditësi të mund të sistemohet për kohë të pacaktuar në pozitë tjetër të punës, ndërsa me shikim në shkresat e lëndës gjykata ankimore vlerëson se nuk ekziston ndonjë plan organizativ i të paditurës, në bazë të cilit e njëjta do të mund të bënte ndryshimin e vendit të punës për paditësin siç edhe ka vepruar, përkundrazi në shkresa të lëndës shihet se paditësi për punën e tij disa vjeçare të e paditura, ka marrë mirënjohje dhe certifikata të shumta nga institucione vendore dhe ndërkombëtare.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se me sistemim të paditësit në një vend tjetër të punës ai është dëmtuar në të ardhura personale në shumën prej 40 euro në muaj, në emër të rrezikshmërisë në punë, ashtu siç është vërtetuar me ekspertizë financiare. Është obliguar e paditura në pagesën e

të ardhurave si dhe kamatën 8%, duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzime të procedurës është vendosur bazuar në nenin 452, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së.

Përfaqësuesi i të paditurës në revizionin e paraqitur për nga baza i është referuar shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, mirëpo në arsyetim të revizionit nuk ka përmendur shprehimisht ndonjë dispozitë ligjore apo ndonjë arsye për ndonjë shkelje procedurale, prandaj Gjykata Supreme sa i përket kësaj baze është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në përputhje me dispozitën e nenit 215 të LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme nga ka rezultuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Në këtë rast, siç rezulton edhe nga shkresat e lëndës, paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura në pozitën Shef i Njësisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike, ndërsa e paditura ka marrë vendimin me numër 07/1-01A/1074, datë 23.01.2019, ku pa dhënë ndonjë arsye e ka sistemuar për kohë të pacaktuar në një vend tjetër të punës, përkatësisht në pozitën Shef i NJKE, në Drejtorinë Rajonale Prishtinë, Sektori i Operativës Rajonale, SP Prishtinë Veri, Sektori i Operativës, ekipi reagues "B", Udhëheqës i Ekipit Reagues. Me vendimin e shkallës së dytë përkatësisht vendimin e komisionit të ankesave ka mbet në fuqi vendimi i sipërtheksuar, ndërsa si arsye dhe bazë për transferim është përmendur nevoja operationale dhe dispozitat nga neni 32 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018. Kjo gjykatë vlerëson se çdo vendim që merret në raport me punëtorin, përkatësisht vendin e tij të punës, përfshirë këtu edhe sistemimin në ndonjë vend tjetër të punës, punëdhënësi ka për obligim që mbi bazën ligjore të caktuar të jep arsye të qarta dhe të plota për domosdoshmërinë e ndërhyrjeve në statusin e të punësuarit. Në këtë rast e paditura ka përdorë si bazë ligjore për këtë sistemim dispozitat nga neni 32 të udhëzimit të sipërtheksuar, e cila parasheh mundësinë që për shkak të nevojave operationale të shërbimit, punonjësi pa pëlqimin e tij të sistemohet në një vend tjetër të punës në kohë të caktuar apo të

pacaktuar, mirëpo sipas kësaj gjykate për të gjetur zbatim baza e tillë ligjore punëdhënësi ka për obligim që me prova konkrete të vërtetoj ekzistimin nevojave operationale dhe se nevojat janë të tilla që detyrimisht imponojnë ndryshimet e tilla, përkatësisht ndërrim të vendit të punës pa vullnetin e punëtorit.

Kjo gjykatë vlerëson se vendimi me të cilin paditësit i është ndërruar vendi i punës dhe vendimi i shkallës së dytë, me të cilin vendimi i shkallës së parë është vërtetu janë të kundërligjshme, ngase para se të merren këto vendime punëdhënësi nuk ka siguruar ndonjë provë për të vërtetuar ekzistimin e ndonjë nevojë operationale apo ndonjë shkak tjetër që ka të bëjë me performancën e paditësit në raport me vendin e punës ku ka punuar, në mënyrë që të argumentohet baza ligjore që ka të bëjë me sistemimin e pretenduar nga pala e paditur. Në rrethana të tilla rezulton se paditësi është sistemuar në një vend tjetër të punës, ndërsa nuk është dhënë asnjë arsye për sistemim, andaj me të drejtë është detyruar e paditura që ta kthej paditësin në vendin e tij të mëparshëm të punës, duke përfshirë edhe kompensimin sipas pozitës që ka pasë, ashtu siç ka vendosur gjykata e shkallës së dytë në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar me revizion.

Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.479/2023, më 26.03.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari

Zenel Leku